



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assambly of Rahovec



<b>DATË:</b>	22.01.2025
<b>REFERENCË:</b>	01/2025
<b>PËR:</b>	Z. Arbër Zenuni, Kryesues i Kuvendit Komunal Rahovec
<b>CC:</b>	Z. Skender Hamza, Udhëheqës i sektorit për punë në Kuvendin e Komunës së Rahovecit Z. Atdhe Rama, Zv. Kryesues, Komiteti për persona me aftësi të kufizuar Znj. Samra Kërçagu, Anëtare, Komiteti për persona me aftësi të kufizuar Znj. Altina Mezini, Anëtare, Komiteti për persona me aftësi të kufizuar Z. Selman Shtavica, Anëtar, Komiteti për persona me aftësi të kufizuar
<b>NGA:</b>	Znj. Almedina Jaha, Kryesuese, Komiteti për persona me aftësi të kufizuar
<b>TEMA:</b>	Raporti Vjetor i Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Rahovecit për vitin 2024

## 1. Hyrje

Në përputhje me parimet e Deklaratës së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, të drejtat e individëve janë të patjetërsueshme dhe të barabarta për të gjithë. Ky parim është themel mbi të cilin Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Rahovecit ka punuar gjatë vitit 2024 për të siguruar mbrojtjen dhe përfshirjen e të gjithë individëve me aftësi të kufizuara në të gjitha aspektet e jetës. Komiteti ka adresuar çështje të ndryshme të lidhura me shëndetin, edukimin, punësimin dhe infrastrukturën, me qëllim që të sigurohet një standard i jetesës dinjitoze dhe i barabartë për këtë grup shoqëror.

Në Komunën e Rahovecit jetojnë rreth 1006 persona me aftësi të kufizuara. Për këtë kategori, sigurimi i shëndetit dhe qasja në shërbime shëndetësore mbeten çështje kryesore, të cilat kërkojnë angazhim të vazhdueshëm për t'i mundësuar atyre shërbime të barabarta dhe të përshtatshme.

## 2. Qëllimi dhe Objektivat e Komitetit

Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara ka për qëllim adresimin e çështjeve që ndërlidhen me jetën e përditshme të personave me aftësi të kufizuara dhe përfaqësimin e tyre përpara autoriteteve lokale.

Aktivitetet kryesore të Komitetit për vitin 2024 janë orientuar në:

- Përfaqësimin dhe mbështetjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.
- Përmirësimin e kushteve infrastrukturore dhe shërbimeve publike për këtë kategori qytetarësh.
- Nxitjen e integritit social dhe ekonomik të personave me aftësi të kufizuara.

Përmes këtyre aktiviteteve, Komiteti ka synuar të sigurojë një mundësi për personat me aftësi të kufizuara që të kenë një zë të fuqishëm në qeverisjen komunale dhe të angazhohen në përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre.

### **3. Aktivitete dhe Realizime për vitin 2024**

#### **Mbledhjet e Komitetit**

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016, Komiteti organizoi 6 mbledhje të rregullta gjatë vitit 2024. Këto mbledhje ishin mundësi për të diskutuar çështje të ndryshme dhe për të shqyrtuar rekomandimet për autoritetet komunale.

**Mbledhja e parë në muajin Mars:** Në këtë takim u bë përzgjedhja e kryesuesit të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara ku anëtarët unanimitisht zgjodhën kryesuese Znj. Almedina Jaha dhe zëvendës kryesues Z. Atdhe Rama, dhe tre anëtarë të tjerë Samra Kërçagu, Altina Mezini dhe Selman Shtavica.

**Mbledhja e dytë në muajin Maj:** Shqyrtimi dhe aprovimi i planit të punës së Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2024. Ky plan i punës përcaktoi prioritetet dhe aktivitetet kryesore që do të ndërmerren gjatë vitit

**Mbledhja e tretë në muajin Qershor:** Janë realizuar vizita në organizatat joqeveritare (OJQ) që operojnë në Komunën e Rahovecit dhe trajtojnë personat me aftësi të kufizuara, si: Hareja dhe Handikos. Në këto takime janë diskutuar për sfidat dhe nevojat me të cilat përballen në ofrimin e shërbimeve për këtë kategori.

**Mbledhja e katërt në muajin Shtator:** Janë diskutuar masat dhe sfidat në përmbushjen e nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

**Mbledhja e pestë në muajin Nëntor:** Është diskutuar rreth organizimit të një tryeze për nder të Ditës Botërore të Personave me Aftësi të Kufizuara. Në takim prezent ishin Drejtori i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, Z. Afrim Dina, ku është diskutuar mbi bashkëpunimin me Drejtorinë dhe me OJQ-të që trajtojnë personat me aftësi të kufizuara, për organizimin e aktiviteteve të ndryshme për këtë ditë. Poashtu, në takim ishte edhe drejtori i Drejtorisë për Arsim, Z. Avni Morina, ku jemi informuar mbi përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor, pastaj infrastruktura për qasje të përshtatshme, sfidat me të cilat përballlet kjo drejtori dhe çështje të tjera. Poashtu, në takim ishin edhe përfaqësuesit e OJQ ku është diskutuar mbi organizimin e tryezës së rrumbullakët, dhe temat që do të diskutohen.

**Mbledhja e gjashtë në muajin Dhjetor:** Është shqyrtuar draft plani dhe miratuar Plani i Punës së Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2025

Këto takime kanë ndihmuar në forcimin e komunikimit ndërmjet institucioneve dhe OJQ-ve, si dhe në krijimin e një strategjie më të mirë për përmirësimin e kushteve dhe ofrimin e mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara. Rekomandimet dhe vendimet e marra gjatë këtyre takimeve synojnë të nxisin përfshirjen dhe të përmirësojnë cilësinë e jetës së kësaj kategorie në Komunën e Rahovecit.

Komiteti organizoi një tryezë të rrumbullakët më datën 2 Dhjetor, për nder të ditës botërore për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me personat me aftësi të kufizuara. Pjesëmarrës ishin përfaqësues të institucioneve publike, organizatave joqeveritare dhe shoqërisë civile që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, posaçërisht mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara.

Pas analizimit të situatës dhe diskutimeve të zhvilluara gjatë tryezës, u evidentuan problemet dhe sfidat kryesore, si dhe u propozuan disa rekomandime për përmirësimin e situatës së personave me aftësi të kufizuara (PAK). Ato janë si më poshtë:

**Konkluzionet e dala nga tryeza e rrumbullakët**

- Qasja në institucionet publike për personat me aftësi të kufizuara nuk është në nivelin e duhur.
- Është rritur numri i rasteve të personave me aftësi të kufizuara që vuajnë nga çrregullime mendore dhe psikiatrike.
- Ka mungesë të theksuar të asistencës për këtë kategori.
- Detyrat e kujdestarëve për personat me aftësi të kufizuara mendore nuk po kryhen siç duhet.
- Nuk po ofrohen shërbime fizioterapeutike falas për personat me aftësi të kufizuara.
- Ekziston mungesë e punësimit për personat me aftësi të kufizuara.
- Numri i personave të prekur nga autizmi është në rritje.
- Shërbimet logopedike nuk po ofrohen në mënyrë të mjaftueshme.
- Ka pasur zvogëlim të buxhetit nga pushteti qendror, duke ndikuar negativisht në ofrimin e shërbimeve për PAK.
- Personat me aftësi të kufizuara mendore përballen me sfida të mëdha në ngritjen e zërit për të drejtat e tyre.

**Rekomandimet e dala nga tryeza e rrumbullakët**

- Të ndërtohet një shtëpi për qëndrim ditor për personat me çrregullime psikiatrike dhe mendore.
- Të rritet numri i mësimitdhënësve mbështetës, psikologëve dhe pedagogëve në shkollat e komunës së Rahovecit.
- Të krijohet një ekip vlerësues (komision) për të identifikuar dhe vlerësuar nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara.
- Të krijohen dhoma burimore për PAK në shkolla për të siguruar mbështetje adekuate.
- Të përmirësohet dhe të zgjerohet ofrimi i shërbimeve logopedike dhe fizioterapeutike falas për PAK.
- Të rritet ndërgjegjësimi dhe të sigurohet përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës.
- Të alokohet një buxhet më i madh dhe më i drejtë për nevojat e PAK nga pushteti qendror dhe lokal.
- Të ndërmerren hapa konkretë për rritjen e qasjes së personave me aftësi të kufizuara në të gjitha institucionet publike.
- Këto masa janë të domosdoshme për të garantuar të drejtat dhe mirëqenien e personave me aftësi të kufizuara, si dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre.

**Vizitat dhe Senzibilizimi**

Në kuadër të aktiviteteve dhe vizitave të parapara nga Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara të Komunës së Rahovecit, u realizua vizita në komitetin homolog në Komunën e Gjakovës.

#### **Qëllimi i Vizitës**

- Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira ndërmjet komiteteve.
- Diskutimi mbi sfidat dhe zgjidhjet e aplikuara në komunat respektive për përmirësimin e kushteve për personat me aftësi të kufizuara.
- Identifikimi i mundësive për bashkëpunim të mëtejshëm ndërkomunal në fushën e mbështetjes dhe përfshirjes së kësaj kategorie.

#### **Rezultatet e Vizitës me Komitetin e Komunës së Gjakovës:**

- Shembuj konkretë të projekteve për ngritjen e kapaciteteve të personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre.
- Roli i drejtpërdrejtë i komitetit në hartimin dhe monitorimin e politikave lokale për këtë kategori.
- Qasja inovative në organizimin e aktiviteteve ndërgjegjëse për komunitetin e gjerë.
- Praktika të suksesshme për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës.
- Iniciativa për përmirësimin e qasjes në infrastrukturën publike dhe institucionet arsimore.
- Modele të bashkëpunimit efektiv me organizatat joqeveritare që trajtojnë personat me aftësi të kufizuara.

#### **Aktivite Senzibilizuese**

##### **Shënimi i Ditës Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara**

- Shënimi i Ditës Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara me aktivitete kulturore, sportive dhe informuese.
- Organizimi i tryezes si dhe aktivitete të ndryshme sportive në palestren e qytetit.

#### **4. Monitorimi dhe Raportimi i Planit të Veprimit**

Komiteti ka monitoruar me vëmendje zbatimin e planit të punës për vitin 2024. Aktivitetet janë realizuar në përputhje me rekomandimet e dalë nga mbledhjet, tryezat e rrumbullakëta dhe vizitat e realizuara. Komiteti ka paraqitur raporte të detajuara dhe ka bërë rekomandime për përmirësimin e kushteve dhe shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Rahovecit.

#### **5. Rekomandimet për Vitin 2025**

Bazuar në përvojën e vitit 2024, Komiteti rekomandon:

- Përmirësimin e infrastrukturës publike për të siguruar qasje të plotë për personat me aftësi të kufizuara.

- Rritjen e mundësive për punësim për personat me aftësi të kufizuara.
- Nxitjen e mëtejshme të aktiviteteve edukative dhe kulturore që përfshijnë personat me aftësi të kufizuara.
- Zbatimin e politikave lokale që promovojnë barazinë dhe integrimin e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri.

## 6. Përfundim

Viti 2024 ka qenë një vit i rëndësishëm për Komitetin Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Rahovec. Pavarësisht sfidave të hasura, përpjekjet për përmirësimin e kushteve të jetesës për personat me aftësi të kufizuara vazhduan të jenë një prioritet. Komiteti është i angazhuar të vazhdojë punën e tij në vitin 2025 dhe në vitet e ardhshme, duke përmirësuar më tej mundësitë përfshirëse dhe duke ofruar mbështetje të vazhdueshme për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Rahovecit. Kjo do të realizohet përmes forcimit të bashkëpunimit me institucione të tjera, organizata joqeveritare dhe shoqërinë civile, si dhe përmes ngritjes së kapaciteteve të Komitetit dhe përfaqësuesve të tij. Angazhimi dhe koordinimi i vazhdueshëm do të sigurojë që personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta dhe të gëzojnë të gjitha të drejtat e tyre, pa diskriminim.

### Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Rahovec

Almedina Jaha ( Kryesuese)  
 Atdhe Rama ( Zëvendës kryesues)  
 Samra Kërçagu (Anëtare)  
 Altina Mezin ( Anëtare)  
 Selman Shtavica ( Anëtar)

Almedina Jaha  
 Kryesuese e Komitetit

